

Një Vështrim mbi Treguesit e Zhvillimit Ekonomik të Shqipërisë 6MI 2026

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Korrik 2026

Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.



Përmbajtja

- Llogaritë Kombëtare
- Tregtia e Jashtme
- Tregu i Punës
- Investimet e Huaja Direkte
- Tregues Monetar



Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë

Rritja ekonomike T1 2026 - Ekonomia shqiptare vijon të ruajë një ritëm të qëndrueshëm rritjeje, me PBB +3,7% në T1 2026. Rritja mbështetet kryesisht nga Administrata Publike (+13,9%), Pasuritë e Paluajtshme (+9,0%) dhe Shërbimet Profesionale (+7,3%), ndërsa Industria (-2,2%) dhe Bujqësia (-0,5%) vijojnë të tkurren.

Tregtia e Jashtme - Tregtia e jashtme mbetet sfidë, me eksportet 193 mld lekë (+6%), importet 450 mld lekë (+4%) dhe rritje të deficitit tregtar në 256 mld lekë (+2,9%).


Inflacioni dhe kurset e këmbimit - Stabiliteti makroekonomik është ruajtur, me inflacion mesatar 2,7%, ndërsa leku vazhdon të forcohet (95,8 ALL/EUR dhe 82,1 ALL/USD mesatarisht gjatë 6M 2026).

Tregu i Punës - Tregu i punës vazhdon të përmirësohet, me papunësi 8,4%, pjesëmarrje në fuqinë punëtore 76,2% dhe pagë mesatare 90.119 lekë (+7,4%), megjithëse sfidat e produktivitetit dhe mungesës së fuqisë punëtore mbeten të pranishme.

Kredia dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) - Financimi i ekonomisë vijon të zgjerohet, me 978 mld lekë kredi për ekonominë dhe IHD +11,9% në T1 2026. Megjithatë, 43% e flukseve të IHD-ve orientohen drejt pasurive të paluajtshme, duke treguar përqendrim të investimeve në sektorë jo domosdoshmërisht me produktivitet të lartë.


Rritja Ekonomike Sipas Tremujorëve

Rritja tremujore PBB në %



Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në tremujorin e parë të vitit 2026 vlerësohet të rritet me 3,71%, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025. Një vit më parë, kjo rritje ishte 3,76%.

Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve




"Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia" shënoi rritje prej 13,93 %, i ndjekur nga aktiviteti "Pasuri të Paluajtshme" me 8,99 %. Grupi "Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative" shënuan rritje me 7,32 %, "Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit" shënuan një rritje prej 5,0 %, aktiviteti i "Ndërtimit" shënoi një rritje prej 3,3 %, dhe grupi "Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor" shënoi një rritje prej 1,61 %.

Grupi i aktiviteteve: "Industri, Energji dhe Ujë" shënoi rënie prej 2,17 %, "Bujqësi, Pyje dhe Peshkim" shënoi rënie me 0,49 % dhe grupi i aktiviteteve "Arte, argëtim dhe çlodhje dhe aktivitete të tjera shërbimi" shënoi rënie prej 3.48 %. Taksat Neto mbi produktet u rritën me 5,40 %.

Kontributi në Rritja Ekonomike (tremujore)

2026-TI Kontributi në rritje p.p sipas aktiviteteve të ekonomisë




Kontributi sipas aktiviteteve ekonomike paraqitet si më poshtë: “Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia” me +1,68 p.p, “Aktivitete të pasurive të paluajtshme” me +0,52 p.p, “Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative” me +0,47 p.p, “Ndërtimi” me +0,32 p.p, “Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor” me +0,21 p.p, “Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit” me +0,09 p.p, “Informacioni dhe Komunikacioni” me +0,06 p.p.

Aktiviteti “Industri, Energji dhe Uji” kontribuoi me -0,25 p.p, “Art, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi” me -0,07 p.p dhe “Bujqësi, Pyje dhe Peshkim” kontribuoi me -0,06 p.p. “Taksat Neto mbi produktet” kontribuan pozitivisht me +0,74 p.p.

Burimi: INSTAT

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme




Në gjashtë muajt e parë të 2026, eksportet arritën në total 193 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 6% krahasuar me vitin e kaluar;

ndërsa importet arritën në 450 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 4%.

Deficiti tregtar arriti në 257 miliardë lekë, një rritje prej 3% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Importet sipas grupmallrave (në million lekë)




Në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, importet u rritën me 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritje pësuan të gjithë importet e grupmallrave me përjashtim të grupit “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” dhe “Materiale ndërtimi dhe Metale”.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2026, Shqipëria pa rritjen më të madhe me Rusinë (42,7%), Zvicrën (24,9%) dhe Kinën (22,97%); kurse rënien më të madhe të importeve nga Spanja (-14,7%), Maqedonia e Veriut (14,05%) dhe Austria (16,08%), krahasuar me një vit më parë.

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Eksportet sipas grupmallrave (në milionë lekë)



Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, eksportet u rritën me 6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.


Rritja u regjistrua në grupet 'Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' (21,94%) Materiale ndërtimi dhe metale' (14,87%) dhe "Makenari, pajisje dhe Pjesë këmbimi (14,48%); rënie pësuan grupet "Lëkurë dhe artikujt prej tyre" dhe "Prodhime druri dhe letre" krahasuar me 6MI 2025.

Shqipëria regjistroi rritje më të madhe të eksporteve drejt SHBA, Turqi dhe Kroaci krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Në të kundërt, eksportet drejt Spanjës, Ukrainës, Rosisë dhe Zvicrës ranë krahasuar me 6MI 2025.

Burimi: INSTAT


Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave gjatë 6M-I 2026 dominohet nga importet e makinerive, pajisjeve; ushqimit, pijeve, duhanit, produkteve kimike dhe plastike dhe materialeve të ndërtimit dhe metaleve



Eksportet e Mallrave


Struktura e Eksporteve (në %)



Struktura e Eksporteve sipas produkteve ka filluar ndryshimin duke filluar nga viti 2025 ku janë rritur eksportet e minerale, lëndë djegëse, energji elektrike, ushqimet, pijet, duhani makineri pajisje dhe pjesë këmbimi; dhe janë ulur eksportet e Tekstileve dhe këpucë dhe materiale ndërtimi dhe metale.

Indeksi i Çmimit të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %



Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, inflacioni mesatar në bazë vjetore shënoi vlerën prej 2.7%, që është më i lartë se niveli i vitit të kaluar prej 2.1%.

Bazuar në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor në bazë vjetore ka qenë vazhdimisht nën objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3%, por janë vënë re tendenca rritëse duke filluar nga nëntori 2021, ku inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH me norma të larta dhe kjo tendencë vazhdoi deri në tetor 2022 kur inflacioni filloi të binte.


Ndërkohë kemi një rritje të inflacionit mbi objektivin e BSH në muajt maj, qershor 2026.

Burimi: INSTAT




Kursi i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit Lek/Euro



Kursi mesatar i këmbimit Lek/Usd



Në gjysmën e parë të vitit 2026, kursi mesatar i këmbimit për lekun kundrejt euros ishte 95,83, nga 98,68 gjatë së njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Në mënyrë të ngjashme, kursi mesatar i këmbimit për lekun kundrejt dollarit amerikan ishte 82,1, krahasuar me 90,4 një vit më parë. Leku vazhdon të forcohet kundrejt dy monedhave kryesore të huaja të vendit.


Burimi: BSH

Kredia për ekonominë

Totali i kredisë në ekonomi (mln Lekë)




Kredia e re sipas aktivitetit ekonomik mln Lekë



Në maj 2026, kredia totale për ekonominë arriti në 978 miliardë lekë. Pjesa më e madhe e kredisë së re gjatë pesë muajve të parë të vitit 2026 u drejtua drejt tregtisë me shumicë dhe pakicë, ndërtimit dhe industrisë prodhuese, si edhe akomodimit duke vazhduar trendin e vërejtur në vitin e kaluar. Gjatë kësaj periudhe, kreditë e reja totale për korporatat private jofinanciare u rrit me 11%, duke kapur shifrën 118 miliardë lekë.

Forca e Punës

Norma e papunësisë




Shkalla zyrtare e papunësisë për individët e moshës 15+ ishte 8.4%, duke reflektuar një rënie prej 0.3 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025 dhe 0,1 pikë përqindjeje me tremujorin e mëparshëm. Shkalla mbetet më e lartë tek gratë e moshës 15+ sesa tek burrat në të njëjtin grupmoshë.

Në tremujorin e parë të vitit 2026, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për grupmoshën 15-64 vjeç arriti në 76.2%, një rritje prej 0,5 pikësh përqindjeje krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2025 dhe 0,3 pikë përqindjeje me tremujorin e katërt të vitit 2025.

Burimi: INSTAT


Paga Mesatare dhe Paga minimale



Në tremujorin e parë të vitit 2026, paga mesatare u raportua në 90.119 lekë, duke reflektuar një rritje prej 7,4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Paga mesatare mujore në sektorin privat arriti në 83.912 lekë, duke shënuar një rritje prej 11,5% nga viti në vit. Ndërkohë, punonjësit e sektorit publik fituan një pagë mesatare mujore prej 105.390 lekësh, duke përfaqësuar një rritje prej 7,6% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (në Lekë)



Pagat më të larta vazhdojnë të regjistrohen në sektorin "Aktivitete Financiare dhe të Sigurimeve", i cili pa një rritje prej 10,5% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025, i ndjekur nga sektori "Informacion dhe Komunikim" me një rritje prej 8,5% gjatë së njëjtës periudhë.

Pagat më të ulëta u raportuan në sektorin "Bujqësi, Pylltari dhe Peshkim"; megjithatë, ky sektor përsëri përjetoi një rritje prej 11,8% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2025.


Rritja më e madhe e pagave nga viti në vit u vunë re në aktivitetin e Ndërtimit me 16%.

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer


Burimi: INSTAT

Investimet e Huaja Direkte

Fluksi hyrës IHD me bazë tremujore




Stoku IHD me bazë tremujore




Në tremujorin e parë të vitit 2026, flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte (IHD) u rritën me 11,9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, por ranë me 5,3% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2025. Ndërkohë, stoku i IHD-ve për periudhën janar-mars 2026 u rrit me 12% nga viti në vit, duke arritur në 17.437 milionë euro, dhe shënoi një rritje prej 2,6% krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2025.

Investimet e Huaja Direkte

Stoku IHD sipas vendit të origjinës në mln Euro



Fluksi ID sipas shteteve në mln Euro




Austria mban vendin e parë me hyrjet më të larta të IHD-ve për tremujorin e parë të vitit 2026, 60 milionë euro, të ndjekura nga Italia me 49 milionë euro dhe Holanda me 48 milionë euro.

Ndërkohë, Holanda vazhdon kryeson stokun e IHD-ve në vend për tremujorin e parë të vitit 2026, me 2.834 milionë euro, e ndjekur nga Zvicra me 2.374 milionë euro.

Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas aktiviteteve kryesore në mln Euro



Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, sektori më tërheqës për investimet e huaja direkte është Aktiviteti i Pasurive të Paluajtshme, një trend që vazhdon nga tremujori i dytë i vitit 2023 (172 milionë euro), i ndjekur nga Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimeve (68 milionë euro) dhe Energjia Elektrike (38 milionë euro).

Aktivitet e pasurive të paluajtshme përbëjnë 43% të flukseve të Investimeve të Huaja Direkte në vend,